

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, NË CEREMONINË E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES TEKNIKE ME MINISTRINË E MBROJTJES PËR PROJEKTIN PËR LËNDËT KIMIKE
16 prill 2012

Ministri Imami,
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm,
Zonja dhe Zotërinj,

Sot, si Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, pata kënaqësinë që, së bashku me partnerët tanë të Ministrisë shqiptare të Mbrojtjes, të nënshkruajmë një marrëveshje teknike në lidhje me një projekt të ri kushtuar shkatërrimit të lëndëve kimike. Fondet për këtë projekt jepen nga Republika Çeke dhe Turqia, në pjesën më të madhe. Nevojiten akoma më shumë fonde dhe ne po kërkojmë donatorë.

I nderuar ministri Imami, mendoj se kjo shënon një hap tjetër të rëndësishëm të bashkëpunimit tonë.

Ky projekt është pjesë e rëndësishme në kuadrin e përgjithshëm të çmilitarizimit.

Nga këndvështrimi i OSBE-së, ky aktivitet ka një interes jetësor për vendin për dy arsye të shëndosha.

Një arsye e shëndoshë është se shkatërrimi i të gjitha kimikateve të rrezikshme është çështje sigurie: siguri për popullatën, siguri për mjedisin dhe, gjithashtu, siguri për rajonin.

Përpos kësaj, bazuar në mandatin e saj, Prezenca e OSBE-së ka një rol dhe përgjegjësi vendimtare në këtë fushë.

Për më shumë se katër vjet tashmë, që nga shpërthimi i tmerrshëm i Gërdecit, Prezenca e OSBE-së ka qenë e përkushtuar në mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes në përpjekjet e saj për të shkatërruar në mënyrë të sigurt municionet e tepërta dhe kimikatet toksike të rrezikshme.

Sa u përket kimikateve, OSBE-ja ka ndihmuar në shkatërrimin e 34 tonëve të një materiali të njohur me emrin 'melange' në vitin 2009, me fonde nga Danimarka, Finlanda, Greqia dhe Suedia, dhe 120 tonë dikloretani në vitin 2010, me fonde nga Vendet e Ulëta.

Gjithashtu, Prezenca e OSBE-së ka asistuar Ministrinë e Mbrojtjes me pajisje dhe materiale për shkatërrimin e municioneve, në vitin 2010 dhe 2011, me fonde nga Danimarka dhe Gjermania.

Është inkurajuese të shohësh se Ministria e Mbrojtjes po bën vazhdimisht përpjekje të fuqishme për të zhvilluar profesionalisht planin e saj të veprimit për çmilitarizimin, duke shtruar kështu rrugën drejt të qenit një vend i çliruar nga mbetjet e vjetra dhe të rrezikshme të periudhës së Luftës së Ftohtë.

Për këtë arsye, besoj se është e rëndësishme për të gjithë ne që të punojmë në bashkëpunim të ngushtë dhe t'i bashkojmë përpjekjet tona drejt të njëjtit objektiv, që është siguria.

Ministri Imami,

Zonja dhe zotërinj,

Marrëveshja teknike që sapo nënshkruam ka për qëllim shkatërrimin e rreth 80 tonë lëndësh kimike të mbetura e të magazinuara në depo ushtarake.

Me përfundimin e këtij projekti, Shqipëria nuk do t'i ketë më këto kimikate ushtarake të vjetra dhe të rrezikshme. Nuk mendoj se do ta teproja po të thosha: kjo do të jetë një arritje e shkëlqyer!

Lejomëni të falënderoj sërish të gjitha vendet donatore: Republikën Çeke, Danimarkën, Finlandën, Gjermaninë, Greqinë, Vendet e Ulëta dhe Suedinë, të cilat kanë kontribuar deri më tani.

Më lejoni që, në frymën më të mirë të një bashkëpunimi të suksesshëm, t'ju uroj të gjithëve shumë suksese në punën tuaj profesionale.

Ju faleminderit!

Fund